



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Financave

PROJEKT PËR EFIKASITET ENERGJETIK  
NË SEKTORIN PUBLIK  
(IBRD 9038MK)  
NUMRI IDENTIFIKUES I PROJEKTIT : P149990

**SHPALLJE PËR ANGAZHIM PUNE NË KOHË TË CAKTUAR  
LIDHUR ME PROJEKTIN PËR EFIKASITET ENERGJETIK NË  
SEKTORIN PUBLIK**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mori hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore për realizimin e Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik. Qëllimet për zhvillimin e projektit janë: (i) zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorin komunal; dhe (ii) mbështetja e zhvillimit dhe zbatimit të mekanizmit të qëndrueshëm për financimin e efikasitetit energjetik në sektorin publik. Projekti synon t'i realizojë këto qëllime duke mundësuar investime në ndërtesat komunale dhe qeveritare (qendrore) dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Për realizim të suksesshëm të Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik, Ministria e Financave ka nevojë për angazhimin e konsulentit individual lokal për pozicionin vijues afatshkurtër:

**Inxhinieri i elektrikës**

Kompetencat kryesore të Inxhinierit të elektrikës janë: Mbështetje të njësisë për zbatimin e projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik në identifikimin e propozimeve për projekte investuese; Sigurim të përgatitjes së dokumenteve për revizion energjetik në përputhje me kriteret e përcaktuara në doracakun operativ; Vlerësim të rezultateve për revizion energjetik; Koordinim dhe sigurim të kontrollit të cilësisë në përgatitjen e projekteve të nevojshme preliminare dhe të detajuara për efikasitet energjetik; Përgatitje në bashkëpunim të ngushtë me personat zyrtarë për furnizime dhe operacione për menaxhim financiar në vlerësimin e fizibilitetit teknik, financiar dhe ekonomik të investimeve të propozuara, duke përfshirë edhe rishikimin e alternativave për uljen e kostove.

**Kualifikimet e nevojshme:**

- Diplomë universitare për elektroteknikë; Diploma e masterit në këtë fushë do të konsiderohet si përparësi
- Të paktën 5 vjet përvojë profesionale në energjetikë, efikasitet energjetik, sisteme për ndriçim dhe/ose instalime solare FV, përvojë paraprake në revizion energjetik të ndërtesave dhe përgatitje të dokumentacionit të detajuar teknik;
- Përvoja e punës me projekte të financuara nga institucionet ndërkombëtare do të jetë përparësi;
- Përvojë paraprake në zbatimin e projekteve për efikasitet energjetik;
- Përvoja në instalimet solare PV është përparësi e madhe;
- Posedim të njohurive nga rregullatitvat nacionale lidhur me mjedisin jetësor, shërbimet komunale dhe furnizimet përmes agjencive qeveritare;
- Shkathtësi të mira në komunikim;
- Shkathtësi shumë të mira kompjuterike (Word, Excel, Access);
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhës maqedonase dhe njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.



Republika e Maqedonisë së Veriut

**Ministria e Financave**

Personat në pozicionet e përmendura të konsulentëve, do të përzgjidhen në përputhje me Rregulloren për furnizime publike të Bankës Botërore për huamarrësit lidhur me FPI - Furnizimet në kuadër të financimit të projekteve të investimeve nga muaji korrik të vitit 2016, i rishikuar në muajin nëntor të vitit 2017 dhe gusht të vitit 2018 ("Rregullorja për furnizime").

Konsulentët e interesuar të cilët i plotësojnë këto kushte, mund të marrin më shumë informacione në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga ora **08:30** deri në **16:30**, çdo ditë pune nga e hëna deri të premtën.

Konsulentët e interesuar thirren që t'i dorëzojnë biografitë e tyre në gjuhën angleze në mënyrë elektronike në word dokument ose në format pdf i cili përveç tjerash duhet përfshijë edhe verifikimin që e konfirmon kualifikimin e tyre për plotësimin e kualifikimeve të mësipërme. **(në aplikacion duhet të vendoset pozicioni për të cilin aplikohet dhe aplikacioni nuk duhet të jetë më i madh se 10 MB).**

Personat e interesuar duhet t'i dorëzojnë biografitë dhe të gjitha dokumentet e tjera përkatëse të bashkangjitura, në adresën e postës elektronike jo më vonë se data **31 dhjetor të vitit 2021, deri në orën 16:00** në këtë adresë:

Ministria e Financave  
Dame Gruev, 12  
1000 Shkup  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
e-mail:  
aleksandar.najdovski@finance.gov.mk